



Republika e Kosovës
Republika Kosova/ Republic of Kosovo

Këshilli Prokurorial i Kosovës/ Tužilački Savet Kosova/Kosovo Prosecutorial Council

Datë: 01 mars 2019

Këshilli Prokurorial i Kosovës, në bazë të nenit 20 paragrafi 2 të Ligjit Nr. 03/L-224 për Këshillin Prokurorial të Kosovës, dhe në bazë të nenit 2 paragrafi 2 të Ligjit nr. 04/L-273 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjeve që Ndërlidhen me Mandatin e Misionit të Bashkimit Evropian për Sundimin e Ligjit në Republikën e Kosovës, në bazë të Rregullores Nr.08/2016 për Emërimin e Kryeprokurorëve, Rregullores Nr.01/2019 për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores Nr. 08/2016 për Emërimin e Kryeprokurorëve dhe në bazë të Vendimit të Këshillit Prokurorial të Kosovës së datës 01 mars 2019, KPK Nr.115/2019, shpall:

KONKURS

Për emërimin e Kryeprokurorit të Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës

- I. Kandidatët e interesuar për pozitën e Kryeprokurorit të Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës, duhet t'i plotësojnë kriteret e mëposhtme:
 1. Të jenë prokurorë me mandat të përhershëm;
 2. Të mos kenë të ngritur aktakuzë apo të mos jenë të dënuar për veprë penale, me përjashtim të kundërvajtjes;
 3. Të kenë vlerësim pozitiv të performancës, dhe
 4. Të kenë reputacion të lartë profesional dhe integritet moral
- II. Kandidatët e interesuar për Kryeprokuror të Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës, duhet të plotësojnë aplikacionin e publikuar në faqet zyrtare të KPK-së dhe PSH-së.
- III. Kandidatët përveç aplikacionit do të ofrojnë edhe një autobiografi (CV) dhe një Koncept dokument për menaxhimin e prokurorisë, forma e të cilit do të gjendet në faqet zyrtare të KPK-së dhe PSH-së.
- IV. Këshilli Prokurorial i Kosovës inkurajon kandidatët e gjinisë femërore dhe kandidatët nga komunitetet jo shumicë që i plotësojnë kriteret e lartë cekura, që të aplikojnë për pozitën e Kryeprokurorit të Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës.
- V. Konkursi do të jetë i hapur nga data 01 mars 2019 deri më 15 mars 2019.
- VI. Aplikacioni duhet të dorëzohet te znj. Ismije Maxhuni, në katin e katërt (4) të ish ndërtesës së EULEX-it, rruga Luan Haradinaj - Prishtinë, zyra numër 413, të mbyllura në zarf, ose me postë.